

## Njoftim

---

Data: 10 mars 2014

Drejtuar: Autoriteteve të Përgjithshme; Të  
Shtatëdhjetëve Zonalë; Presidentëve të  
Misioneve, të Kunjeve dhe të Distrikteve;  
Peshkopëve dhe Presidentëve të Degëve

Nga: Sektori i Misionarëve (801-240-2222)

Lënda: Ekzaminimi për Tuberkuloz për Misionarët e Kthyer

---

KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

Tuberkulozi është një infeksion i rëndë bakteror që mund të shkatërrojë mushkëritë dhe organe të tjera jetësore. Është e domosdoshme që të gjithë misionarët e kthyer të bëjnë analizat për tuberkuloz sepse ata mund të jenë infektuar me sëmundjen pa iu zhvilluar simptoma të menjëhershme.

Bashkëngjitur është letra që presidentët e misioneve do t'ua japin misionarëve të kthyer, duke i udhëzuar ata të bëjnë analizat për tuberkuloz pak kohë pasi të kthehen në shtëpi. Kopjet elektronike të kësaj letre mund të shkarkohen nga presidentët e misioneve nga Mission President's Portal ([missionary.lds.org/presidents](http://missionary.lds.org/presidents)) ose nga trupa organizative e zyrës së misionit përmes faqes zyrtare Missionary Medical ([missionarymedical.org](http://missionarymedical.org)).

Ne u kërkojmë udhëheqësve vendorë të priftërisë që t'i nxisin misionarët e kthyer të ekzaminohen për tuberkuloz kur kthehen në shtëpi dhe të sigurohen se kanë burime të mjaftueshme për ta marrë këtë përkujdesje.

I/E dashur Plaku/Motra \_\_\_\_\_:

Lënda: Ekzaminimi për Tuberkuloz

Tuberkulozi është një infeksion i rëndë bakteror që mund të shkatërrojë mushkëritë dhe organe të tjera jetësore. Është një infeksion i zakonshëm, me një të tretën e popullsisë së botës të infektuar me të. Personat e infektuar që kolliten, shpesh e përhapin infeksionin tek të tjerët.

Shumica e njerëzve infektohen me tuberkuloz pa zhvilluar simptoma të menjëhershme. Këtij i referohen si *tuberkuloz i fshehur*. Njerëzit me tuberkuloz të fshehur kanë 10 përqind shans ta marrin sëmundjen më vonë.

Kështu, që të mos zhvilloni simptoma të rënda nga ekspozimi i mundshëm ndaj tuberkulozit, është *jashtëzakonisht e rëndësishme* që ju të ekzaminoheni për tuberkuloz sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të ktheheni në shtëpi. Pavarësisht rezultateve të analizave për tuberkuloz para misionit tuaj (qoftë nëse ishin pozitive ose negative), ju akoma duhet të takoheni me mjekun ose të shkoni në institucionin tuaj të shëndetit për të bërë sërish analizat kur të ktheheni në shtëpi. Mund të jenë të nevojshme gjithashtu analiza ose mjekime shtesë.

Nëse diagnostikoheni me tuberkuloz të fshehur, ju duhet të ndiqni rekomandimet e mjekut ose institucionit tuaj të shëndetit bazuar në rregulloren e vendit tuaj për shëndetin. Ju faleminderit që kujdeseni për shëndetin tuaj që të mund të mbeten një shërbëtor i fortë e i shëndetshëm i Zotit gjatë gjithë jetës suaj!

Sinqerisht,

---

Presidenti i Misionit